

**AKT NORMATIV**  
**Nr. 28, datë 6.7.2021**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË NËNSHKRUAR PËR PRODHIMIN  
DHE FURNIZIMIN NGA DHE NDËRMJET *PFIZER OVERSEAS LLC* DHE  
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE TË SHQIPËRISË,  
INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK DHE MINISTRIT TË SHTETIT PËR  
RINDËRTIMIN**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

**Miratimi i marrëveshjes**

Miratimin e marrëveshjes së nënshkruar për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet *Pfizer Overseas LLC* dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, Institutit të Shëndetit Publik dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij akti normativ.

Neni 2

**Hyrja në fuqi**

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**